# DËSHMI ARKIVI

**A-447996**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga Jurgen Klopp |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/nuk-mund-te-luaje-me-me-shqiperine-sulmuesi-i-talentuar-grumbullohet-nga-jurgen-klopp/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 08:01:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 07:57:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 07:56:00 UTC → 16 shtator 2026, 07:58:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9999452b8bc2204d45bd63fb09faaf1089dab663b4afd56afa268bab9888a6a8` |
| TEKSTI | `6157b4eb13f4051778cea7d81fdddaf2caa2abab27ea45c847cb2cd7b66999e2` |
| PAMJA | `332cc04c6577aad7d61cb9dcbb91ffff1b338b2a8d99ef1563c58d42ceb24d31` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e86f72a9be05e3d7976f3f404341a1a742d42812c427ced1c6de60a856f93e06` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e86f72a9be05e3d7976f3f404341a1a742d42812c427ced1c6de60a856f93e06`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga Jurgen Klopp

16/09/2026 09:57



**Brajan Gruda është pranë një tjetër hapi të rëndësishëm në karrierën e tij, teksa pritet të marrë për herë të parë ftesën nga Kombëtarja A e Gjermanisë.**

Sulmuesi i RB Leipzig do të jetë pjesë e listës së Jürgen Klopp për grumbullimin e shtatorit, sipas raportimeve të mediave gjermane.

Jürgen Klopp do të publikojë të enjten listën e tij të parë si trajner i Gjermanisë dhe një nga emrat që pritet të jetë pjesë e saj është edhe Brajan Gruda.

Sipas gazetarit Florian Plettenberg, informacion i publikuar edhe nga “iMiaSanMia”, Gruda do të grumbullohet nga Klopp për ndeshjet e muajit shtator. Për 21-vjeçarin bëhet fjalë për një ftesë historike, pasi edhe pse ka qenë i grumbulluar më parë me Gjermaninë në nivelet e moshave, ai ende nuk ka debutuar me ekipin kombëtar A.

Gruda, i cili aktivizohet te RB Leipzig, po kalon një periudhë të mirë dhe forma e tij duket se ka bindur stafin e ri të Kombëtares gjermane. Shpejtësia dhe aftësia për të luajtur në krahë janë ndër karakteristikat që mund ta bëjnë atë një alternativë të rëndësishme për repartin ofensiv të Gjermanisë.

Emri i Brajan Grudës ka qenë prej kohësh i lidhur edhe me Shqipërinë, për shkak të origjinës së tij shqiptare. Sulmuesi kishte mundësinë të zgjidhte përfaqësimin kuqezi, por në të kaluarën vendosi të vijojë rrugëtimin me Gjermaninë.

Tashmë, me ftesën e parë nga Kombëtarja A gjermane, Gruda është shumë pranë një vendimi që mund ta përcaktojë përfundimisht të ardhmen e tij ndërkombëtare.

Nëse ai do të aktivizohet në një ndeshje zyrtare me Gjermaninë, nuk do të ketë më mundësi të ndryshojë përfaqësuese dhe të luajë për Shqipërinë, sipas rregullave të FIFA-s për ndryshimin e federatës përfaqësuese.

Kështu, një lojtar që dikur ishte në radarët e Shqipërisë mund të jetë tashmë shumë pranë debutimit me një prej Kombëtareve më të rëndësishme të futbollit europian.

Për Klopp, Gruda është një opsion i ri në sulm dhe tekniku gjerman pritet të vlerësojë formën e tij gjatë grumbullimit të shtatorit. Nëse bind në stërvitje dhe në ndeshjet e ardhshme, nuk përjashtohet mundësia që 21-vjeçari të marrë edhe minuta në fushë.

**Top Channel**

## Kombëtarja »

## SPORT • KRYESORE



Liverpooli e mbyll me “tripletë”, Tottenhamit i shuhet ëndrra në Carabao Cup



Nuk i besohet në kampionat, Mario Mitaj merr më në fund minuta me Genoan



Carlos Espí heroi i Madridit, Reali merr fitoren në frymën e fundit



Fundi është afër, Messi do të rikthehet për ndeshjen e fundit me Argjentinën

## ME TË LEXUARAT

- Carlos Espí heroi i Madridit, Reali merr fitoren në frymën e fundit
- Nuk i besohet në kampionat, Mario Mitaj merr më në fund minuta me Genoan
- Fundi është afër, Messi do të rikthehet për ndeshjen e fundit me Argjentinën
- Video/ Mehmeti i “mbyll” gojën trajnerit, i shënon Arsenalit në ndeshjen e parë si titullar këtë sezon
- Al Nassr turpërohet në Champions League Aziatike, Cristiano Ronaldo,

shkarkohet, Palladino bëhet gati për ta zëvendësuar
15/09 23:28

mën titoren në frymën e fundit
15/09 23:27

brenda, ndryshimet në listën e Argjentinës
15/09 23:09

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top News – Tubimi i shqiptarëve në Hagë, policia holandeze: Lironi rrugën!



Top News – UÇK 'zbarkon' në Hagë në pritje të vendimit ndaj udhëheqëve të luftës



Top Channel/ Tinderi "zbulon" një skandal në NATO/ Oficeri spanjoll përfundon nën hetim



Top Channel/ "IA është si një inteligjencë aliene", Bill Gates ngre alarmin për atë që po vjen



Top Channel/ SHBA nis shkurtimet për ushtrinë në Ballkan, preket Maqedonia e Veriut



Top Channel/ Dyfishohet bonusi për pensionistët, vendimi nis më 1 janar 2027




© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.